



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 1150/4 Prot.

Pogradec, më 18.03.2025

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim dhe miratim

KRYETAR I KESHILLIT BASHKIAK

E nderuar znj. Kryetare, Manjola KAMOLLI

Bashkegjitur po ju dergojme per shqyrtim dhe miratim Projekt Vendimin per:
PER “DETAJIMIN DHE PERDORIMIN E FONDIT TE KUSHTEZUAR PER MBROJTJEN CIVILE 2025”

Me respekt,

KRYETARI

Ilir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: _____

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: _____

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më ____ . ____ .2025

PROJEKT-VENDIM

NR. _____, DATË ____ . ____ .2025

PËR

**“DETAJIMIN DHE PERDORIMIN E FONDIT TE KUSHTEZUAR PER MBROJTJEN CIVILE
2025”**

Bazuar ligjit 45/ 2019, “Për mbrojtjen civile”, përkatësisht kreu II, neni 8, shkronja ç, kreu II, neni 23, shkronja d dhe neni 15 të ligjit 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, te ligjit nr. 139/2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore"; VKM 414 dt 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, shkresës nr. 2126/1 prot., datë 19.02.2025 “Dërgohen buxhetet e bashkive për vitin 2025, Këshilli i Bashkisë:

VENDOSI:

1. Të miratojë detajimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile si më poshtë:

Nr	Zërat e shpenzimeve	% e Buxhetit	Shuma e planifikuar
1	Shpenzimet për përballimin e dëmeve nga zjarri dhe fatëkeqësi të tjera natyrore (Kodi i produktit 91707AB)	30%	4,000,000
2	Rehabilitimi i godines se ish gjeologjise	67%	9,038,317
3	Mbikeqyrje Rehabilitimi i godines se ish gjeologjise	~2%	250,000
4	Kolaudim Rehabilitimi i godines se ish gjeologjise	~1%	30,000
	TOTAL	100%	13,318,317

2. Për zbatimin e vendimit të ngarkohet Drejtoria e Ekonomise dhe Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike, pranë Bashkise Pogradec.

3. Vendimi të hyjë në fuqi 10 dite pas shpalljes.



KRYETAR

Manjola KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 1150/9 prot.

Pogradec, më 18.03, 2025

RELACION

Të nderuar Këshilltarë!

Projekt Vendimi që po paraqesim përpara jush për miratim ka të bëjë me detajimin e fondeve për emergjencat civile. Në bazë të pikes c te VKM 414 dt 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, kemi bërë detajimin e fondeve duke respektuar kriteret e vendosura në VKM. Duke u bazuar dhe tek nevojat e Bashkisë dhe Drejtorisë së Emergjencave kemi dërguar për miratim nga ana juaj të gjitha zërat si më poshtë:

Nr	Zërat e shpenzimeve	% e Buxhetit	Shuma e planifikuar
1	Shpenzimet për përballimin e dëmeve nga zjarri dhe fatëkeqësi të tjera natyrore (Kodi i produktit 91707AB)	30%	4,000,000
2	Rehabilitimi i godines se ish gjeologjise	67%	9,038,317
3	Mbikeqyrje Rehabilitimi i godines se ish gjeologjise	~2%	250,000
4	Kolaudim Rehabilitimi i godines se ish gjeologjise	~1%	30,000
	TOTAL	100%	13,318,317

- 30% e Fondit do të përdoret për “Shpenzimet për përballimin e dëmeve nga zjarri dhe fatëkeqësi të tjera natyrore”, të cilat miratohen me VKB dhe më pas bëhet likuidimi i tyre. Ne kete fond jane perfshire dhe VKB te cilat jane miratuar ne Janar 2025 per Z.Fahri Biba, Z. Avni Biba, Z. Erton Baçi, Z. Rexhep Biba, ku shuma e te gjitha VKB shkon 3,500,000 leke dhe pjesa tjetere do te mbetet reserve nese do te kemi fatkeqesi te tjera.



- 70% e Fondin do te perdoret per "Rehabilitimi i godines se ish gjeologjise"

Duke pasur ne konsiderate numrin e larte te kerkesave per Banesa Sociale qe i referohen cdo vit Drejtorise se Emergjencave prane bashkise Pogradec, me projekt – buxhetin e viti 2025 eshte menduar te investohet ne ndertimin e disa ambjenteve qe do te sherbejne si banesa sociale dhe strehimi per nevoja te bashkise Pogradec.

Qëllimi i këtij projekti është rikonstruksioni I disa ambjenteve te repartit te ish Gjeologjise per ta kthyer ne ambjente per banesa sociale dhe përmirësimi i kushteve të objektit, për ta bërë atë më funksional dhe të sigurt për përdorim.

II. Informacione të Përgjithshme mbi Objektin

- Emri i objektit: REHABILITIMI I GODINES SE ISH GJEOLOGJISE
- Vendndodhja: Lagjia nr.1 Rruga Industriale
- Përshkrimi i objektit: Ky objekt është qe ka shërbyer si reparti i ish Gjeologjise. Ai ka një strukture tre kateshe, i cili ka nevojë për disa ndërhyrje për të përmirësuar kushte si siguria dhe komoditeti.

III. Gjendja e Objektit dhe Dëmtimet e Posaçme

Objekti ka kaluar një periudhë të gjatë pa rinovime të konsiderueshme dhe ka disa dëmtime që kërkojnë ndërhyrje urgjente. Dëmtimet kryesore janë si vijon:

1. Probleme me strukturën: Ka shenja të çarjeve në disa pjesë të murit, të cilat kanë ndikuar në stabilitetin e objektit.
2. Lagështia dhe dëmtimi i mureve: Pjesë të mureve janë të dëmtuara nga lagështia, duke krijuar mundësi për zhvillimin e mykut dhe përkeqësimin e kushteve të brendshme.
3. Dëmtimi i dyshemeve: Dyshemetë janë të vjetra dhe në disa zona janë dëmtuar.
4. Instalime të vjetra elektrike dhe hidraulike: Sistemet e ujit dhe elektricitetit janë të vjetra dhe kërkojnë modernizim për të përmbushur standardet aktuale të sigurisë dhe funksionalitetit.

IV. Plani i Rikonstruksionit

Plani i rikonstruksionit përfshin disa hapa të rëndësishëm për restaurimin dhe përmirësimin e

objektit:

1. Rikonstruksioni i strukturës: Do të bëhet forcimi dhe riparimi i murit, duke siguruar qëndrueshmërinë e objektit dhe eliminimin e çarjeve.



2. Izolimi i lagështisë: Pjesët e dëmtuara nga lagështia do të rinovohen dhe do të përdoren materiale moderne për të parandaluar rikthimin e lagështisë dhe zhvillimin e mykut.

3. Rikonstruksioni i dysHEMEVE: Dyshemetë do të riparohen dhe/ose do të zëvendësohen me materiale të reja, më të qëndrueshme dhe të lehta.

4. Modernizimi i sistemeve elektrike dhe hidraulike: Instalimet elektrike dhe hidraulike do të rinovohen dhe do të zëvendësohen me sisteme më të sigurta dhe më efikase.

5. Përmirësimi i kushteve të sigurisë: Do të instalohen sisteme të reja të sigurisë, përfshirë dritare dhe dyer me materialet dhe standardet e nevojshme për siguri më të lartë.

V. Kostoja dhe Afati i Realizimit

Pas vlerësimeve të bëra, pritet që kostoja e rikonstruksionit të jetë rreth 9,000,000 leke me tvsh. Në këto kosto përfshihen kostot e shpenzimeve për rikonstruksionin e objektit dhe kostot e mbikqyrjes dhe kolaudimit të tij. Afati për përfundimin e projektit është 6 muaj.

VI. Përfundim

Rikonstruksioni i këtij objekti është një hap i domosdoshëm për përmirësimin e kushteve të tij dhe për sigurimin e një ambienti të sigurt dhe komod për përdorim. Ky projekt do të mundësojë që objekti të shërbejë si Banesa Sociale dhe Strehimi për nevoja të ndryshme të Bashkisë Pogradec.

Ky Projekt Vendim cilësohet si Akt Normativ.

Konceptoi: Besmira Niko

Konfirmoi: Irsa Karapança

Miratoi: Paskalino Ziko

K R Y E T A R I

Ilir XHAKOLLI